REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova - Government of Kosova
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Ref.Nr. 2500/2018
Data 23-07-2018
Datum
Date
Nënshkrimi
Potpis
Signature
PRISHTINË/PRIŠTINA, PRISHTINA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 Ligji per Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe te Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rishpall :

KONKURS

Titulli i punës: Kostumograf /e

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës- IX

Paga: Page fikse

Numri i referencës: 31/2018-R

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bën përgatitjen dhe të mbaruarit e skicës kostumografike;
2. Kryen në mënyrë studiuese përgatitjen për punë kostumografike për shfaqje, mbledhë dhe studion dokumentacionin në bazë të veprës;
3. Punon skicat e kostumeve, 7 maskave, këpucëve, cilindrave, aplikacioneve, stolive, armëve etj.;
4. Dorëzon skicën e plotë kostumografike për të marr leje nga komisioni pas konsultimit me regjisorin dhe skenografinë;

5. Prezanton në të gjitha provat në punëtorinë e rrobaqepësisë në skenën e teatrit;
6. Bën patinimin e kostumeve.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë e Fakultetit te Arteve, drejtimi -dizajn i skenografisë dhe kostumografisë;
2. Të ketë të realizuara kostumografitë, në 2 shfaqje, të paktën 1, në Teatrin Kombëtar të Kosovës (duhet dëshmohet me referenca nga regjisorët dhe kontrata);
3. Të ketë shkathtësi komunikimi dhe aftësi të punës në presion;
4. Njohja e gjuhës Angleze është përparësi .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin per Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe te Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore.

Kohëzgjatja e emërimit: Kandidati qe pranohet, përmes Konkursit publik, merr kontratë 6 mujore për periudhën provuese , me mundësi të vazhdimit sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomë e fakultetit të arteve, drejtimi- Dizajn i skenografisë dhe kostumografisë ;
- Dëshmitë me referenca nga regjisorët dhe kontrata, për 2 shfaqje të realizuara, të paktën 1, të realizuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës;
- Dokumenti i identifikimit.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 07.08.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.
Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen http://www.mkrs-ks.org/)